



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25 Prill 2023

Nr: 414

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**VENDOSJEN NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE TË SHËNIMIT PÛRKATËS IDENTIFIKUES TË
MATERIALEVE PROPOGANDISTIKE ZGJEDHORE**

Sot më datë 25 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Organizata “Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara” (KRIIK)

OBJEKT: Detyrimin e subjekteve zgjedhore për të vendosur shënimin identifikues të prodhuesit të materialeve propagandistike vizive që përdoren për fushatë zgjedhore.

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe pika 2, si dhe nenit 79, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Organizata “Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara” (KRIIK), ka paraqitur në Komisionin Qendror i Zgjedhjeve, në datën 18.04.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, sinjalizim mbi afishimin publik të materialeve propagandistike zgjedhore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë i cili është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.



Sipas KRIIK asnjë prej posterave të publikuar nuk respektojnë parashikimin e pikës 3, të nenit 79, të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton se: *“Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”*.

Posterat përmbajnë vetëm logon e Partisë Socialiste të Shqipërisë, por që në asnjë rast nuk mund të barazohet dhe zëvendësohet vendosja e logos së partisë, qoftë formalisht, qoftë përmbajtësisht, me mbishkrimin që duhet të ketë çdo poster sipas parashikimit të Kodit Zgjedhor.

Nga verifikimi që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë, si dhe në vlerësim të dokumentacionit të administruar në seancë publike, rezulton se është e vërtetë që edhe pse materialet propagandistike përmbajnë logo të Partisë Socialiste, atyre ju mungon shënimimi që duhet të kenë, sikurse përcakton neni 79, pika 3, e Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” dhe pika 2, si dhe nenin 79, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V E N D O S:

1. Subjektet zgjedhore, jo më vonë se data 28 Prill 2023, të vendosin shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor), në të gjitha materialet propagandistike të afishuara në vendet publike.
2. Ky vendim do ju njoftohet subjekteve zgjedhore, nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI